



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 23.
Prishtinë, më 02.12.2011 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Munguan: Jelena Bontic dhe Petar Miletic

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues EUSR Visar Bivolaku, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: zyrtare e lartë e fushës, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave nr 04/ L-44, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-69 për të Huajt, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-73 për Azilin, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-70 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-78 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-40/1 për Rregullimin e tokës, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim, me amendamente.

9. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-54, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente.**
10. **Të ndryshme.**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua me shumicë votash me plotësim të pikës: shqyrtimi i Projektligjit për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-74, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim, me amendamente.

Kryesuesi- në fjalën e tij tha se në bazë të vendimit të mbledhjes plenare dhe në bazë të kërkesës së grupit Parlamentar „Vetevendësja“, emërohet anëtar i Komisionit për Komunitete dhe Kthim Glauk Konjufca në vend të deputetit, Agim Kuleta.

Njëherit i shpreh mirëseardhje Z. Konjufca dhe konsideron se do të ketë bashkëpunim të mirë në këtë komision.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluara.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 18.11.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave nr 04/ L-44, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, pas shqyrtimit të propozim amendamenteve të propozuara nga Komisioni Funksional, në Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave nr 04/ L-44 , Komisioni me shumicë të votave, nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave nr 04/ L-44 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisionit funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-69 për të Huajt, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjit nr. 04/L-69 për të Huajt, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-69 për të Huajt dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-73 për Azilin, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-73 për Azilin, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-73 për Azilin dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-70 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-70 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-70 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-78 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në nr. 04/L-78 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-78 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-40/1 për Rregullimin e tokës, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim, me amendamente..

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-40/1 për Rregullimin e tokës, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-40/1 për Rregullimin e tokës dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-54, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-54, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre , të propozuara nga Komisioni Funkcional.

Në fjalinë e tij veçoi, se në këtë projektligj janë dhënë dy propozime, amendamentet e komisionit Funkcional dhe amendamentet e propozuara nga deputeti Salih Asllanaj, Njëherit kërkoi nga anëtarët të deklarohen veçmas për dy propozimet , në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funkcional.

Glauk Konjufca- në fjalinë e tij tha se në kuadër të fushëveprimit dhe përgjegjësi të komisionit do të ofroj përkrahje te duhura gjatë shqyrtimit të të gjitha çështjeve lidhur me të drejtat dhe interesat e komuniteteve **jo shumicë**.

Me theks të veçantë tha, se lidhur me këtë projektligj, në amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk i përkrah, ndërsa deklarohet se përkrah amendamentet e propozuara nga deputeti Salih Asllanaj,

Lirije Kajtazi – lidhur me Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre , ajo shprehu qëndrimin e saj, se përkrah amendamentet e komisionit funksional ndërsa nuk jep pëlqimin në amendamentet e propozuara nga deputetit Salih Asllanaj,.

Pas diskutimeve të shumta, Kryesuesi konstatoi që Komisioni të votojë për amendamentet e Komisionit funksional dhe me shumicë votash nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligji nr. 04/L-54 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Komisioni shqyrtoi edhe amendamentet e propozuara nga deputeti Sali Asllanaj, në Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, nuk përkrahen.

Arsyetim

Komisioni shqyrtoi amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe vlerësoi se amendamentet e propozuara u miratuan me shumicë të votave, me një abstenim, të deputetit Glauk Konjufca.

Komisioni shqyrtoi edhe amendamentet e propozuara nga deputeti Sali Asllanaj, të cilat me shumicë të votave nuk u përkrahen, me një votë pro të deputetit Glauk Konjufca dhe një votë abstenim të deputetes Lirije Kajtazi.

10. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-74, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin **për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-74**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin **për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-74** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje Plenare të Kuvendit.

11. Të ndryshme.

Kryesuesi-. Me qëllim të vazhdimit të punës dhe të sigurimit të interesave vitale të komuniteteve, Komisioni ka vendosur të bëjë monitorimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Lidhur me këtë iniciativë komisioni ka hartuar Planin për monitorim të ligjit i cili kalonte pesë faza, për këtë fjalën ia dha kryetarit të grupit punues.

Elmi Reçica- tha se komisioni në bazë të Planit të Veprimit është në procedim të monitorimit të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Ne vazhdimësi të procesit të monitorimit të ligjit, Komisioni do të bëjë vizita në disa komuna të Kosovës. Ai propozoi që vizita në terren të bëhet nga anëtarët e komisionit në përbërje të plotë.

Në bazë të informatave nga administrata që mbështet komisionin, vizitat do të organizohen në Komunën e Graçanicës dhe Han të Elezit ,dita e pare, Prizren dhe Mamush, dita e dyte.

Gjithashtu komisioni do të mbajë dëgjim publik, një ditor, i cili do të mbahet në javën e tretë të muajit dhjetor. Ne dëgjim publik do të ftohen zyrtarët komunal për komunitete, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme që mbështesin punën e komisionit

Ai konstatoi, se me qëllim të përmbledhjes së informatave të nevojshme, këshillimeve dhe sugjerimeve lidhur me projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, Komisioni do të hartoj raportin final i cili do të procedohet për miratim në Kuvend.

.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic